

**LIGJI Nr. 04/L-102
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ADMINISTRATËN
TATIMORE DHE PROCEDURAT Nr. 03/L-222**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE
PROCEDURAT Nr. 03/L-222**

Neni 1

Pas nenit 1 të ligjit bazik shtohet nen i ri 1. A me emërtimin dhe përmbajtjen si vijon:

**Neni 1.A
Qëllimi i ligjit**

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i procedurave të reja ankimore kundër vendimeve të organeve tatimore.

Neni 2

1. Neni 1 i ligjit bazik, përkufizimin 1.6. Bordi i Pavarur i Rishqyrtimit, ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

1.6. Bordi i Pavarur për Rishqyrtime – është bordi për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve lidhur me tatimet.

2. Neni 1 i ligjit bazik pas përkufizimit 1.45. shtohen edhe dy përkufizime të reja 1.46. dhe 1.47. me tekstin si vijon:

1.46. Divizioni Fiskal - është divizioni i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me Ligjin për gjykatat dhe që vepron në kuadër të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

1.47. Sektori Fiskal – përfshinë Departamentin e Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës, Sektorin e Ankesave në Doganat e Kosovës dhe Komisionin për shqyrtimin e ankesave në tatimin në pronë në Ministrinë e Financave.

Neni 3

1. Neni 77 i ligjit bazik paragrafi 6. riformulohet si në vijim:

6. Një tatimpagues i cili nuk e pranon vendimin e Sektorit të Ankesave mund të ankohet në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të njoftimit për vendim, për të gjitha vendimet e pranuar deri më 30 nëntor 2012. Duke filluar nga 1 dhjetori 2012, gjykata kompetente përgjegjëse për të pranuar ankesat kundër vendimeve të Sektorit të Ankesave duhet të jetë Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të

Prishtinës. Afati brenda të cilës duhet të dorëzohet ankesa tek gjykata kompetente duhet të jetë tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit të vendimit të Sektorit të Ankesave.

2. Neni 77 i ligjit bazik paragrafi 8. riformulohet si në vijim:

8. Kur Sektori i Ankesave nuk ka dorëzuar një vendim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data kur ankesa është dorëzuar, tatimpaguesi mund të ankohet ndaj vlerësimit të çdo vendimi tjetër zyrtar drejtpërdrejtë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime, deri më 30 nëntor 2012. Duke filluar nga 1 dhjetori 2012, nëse Sektori i Ankesave nuk ka dorëzuar ndonjë vendim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data kur ankesa është dorëzuar, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejtë për vlerësimin fiskal ose ndonjë vendim tjetër zyrtar në gjykatën kompetente, siç është përkufizuar në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 4

Neni 78 i ligjit bazik emërtohet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 78

Bordi i Pavarur për Rishqyrtime

Bordi i Pavarur për Rishqyrtime, i themeluar sipas këtij ligji do të jetë përgjegjës për të pranuar dhe për t'u marrë me të gjitha ankesat e tatimpaguesve, të cilat duhet të dorëzohen deri më 30 nëntor 2012 dhe të atyre të pazgjidhura deri në atë kohë, në pajtim me juridiksionin e caktuar nga ky ligj.

Neni 5

Neni 79 i ligjit bazik paragrafi 5. riformulohet si në vijim:

5. Nëse faktet e reja bëhen të njohura gjatë procedurës në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime ose brenda procedurave që fillojnë në Divizionin Fiskal, këto fakte mund të përdoren nga ATK-ja për të bërë vlerësimet e ndonjë takse shtesë që mund të shkaktohet, me kusht që koha e kufizuar - parashkrimi, nuk ka kaluar.

Neni 6

1. Neni 80 i ligjit bazik paragrafi 5. riformulohet si në vijim:

5. Nëse vendimi i Bordit nuk dorëzohet tek palët brenda periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditëve, siç është caktuar nga ky paragraf, ankuesi mund të ushtrojë ankesë në gjykatën kompetente në bazë të dispozitave të caktuara nga ky ligj dhe Ligjin për konfliktet administrative 03/L-202. Gjykata kompetente gjatë marrjes me ankesat e dorëzuara sipas këtij neni duhet të jetë:

5.1. Gjykata Supreme deri më 31 dhjetor 2012.

5.2. Gjykata e Apelit duke filluar nga 1 janari 2013.

2. Neni 80 i ligjit bazik paragrafi 6. riformulohet si në vijim:

6. Të gjitha rastet e pazgjidhura në Bord para datës 30 nëntor 2012, duhet të vendosen nga i njëjti jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2013.

Neni 7

Neni 81 i ligjit bazik paragrafi 1. emërtohet dhe riformulohet si në vijim:

Neni 81

Shqyrtimi gjyqësor

1. Kundër vendimeve të Bordit mund të ushtrohet ankesë në gjykatën kompetente, me kusht që ankesa të jetë dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimi të vendimit në:

1.1. Gjykatën Supreme për vendimet e pranuar deri më 31 tetor 2012.

1.2. Gjykatën e Apelit për vendimet e pranuar duke filluar nga 1 nëntori 2012.

Neni 8

Pas nenit 81 të ligjit bazik, shtohen 10 nene të reja 81.A, 81.B, 81.C, 81.D, 81.E, 81.F, 81.G, 81.H, 81.I, 81.J si në vijim:

Neni 81. A Ankesat në gjykatë

1. Duke filluar nga 1 janari 2013, Divizioni Fiskal, merr përgjegjësitë e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, dhe është organi i shkallës së parë gjyqësor, ku mund të dorëzohet një ankesë ndaj Departamentit të Ankesave.

2. Divizioni Fiskal, themelohet dhe mbështetet nga Këshilli Gjyqësor në Kosovë, në pajtim me Ligjin mbi gjykatat.

3. Këshilltarët profesional mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve të Divizionit Fiskal. Kushtet e caktimit, shkarkimit dhe statusit të ekspertëve teknik përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 81. B Juridiksioni

1. Divizioni Fiskal është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

2. Juridiksioni i ankesave të Divizionit Fiskal, i mbulon tatimet dhe detyrimet në vijim:

2.1. tatimin mbi të ardhurat personale;

2.2. tatimin mbi të ardhurat e korporatave;

2.3. Ligjin e TVSH-së;

2.4. detyrimet doganore;

2.5. detyrimet e akcizës;

2.6. tatimi mbi pronën e paluajtshme;

2.7. çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Kosovë.

3. Kundër vendimeve të Divizionit Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit.

Neni 81.C Përgjegjësitë, rregullat përbërëse dhe procedurale

Për çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj në lidhje me përgjegjësitë dhe rregullat procedurale të gjykatave kompetente, Ligji mbi konfliktet administrative, plotësim dhe ndryshim i Ligjit 03/L-202 dhe çdo ligj tjetër në fuqi në Kosovë duhet të zbatohet. Në rast të kundërshtimeve të këtij ligji me ligjet tjera dispozitat që gjenden në këtë ligj duhet të mbizotërojnë.

Neni 81. D Palët

1. Parashtruesi i ankesës përballë Divizionit Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës duhet të jetë tatimpaguesi i cili ka pranuar vendimin e kundërshtuar nga administrata kompetente fiskale, doganore ose administrata komunale:

1.1. para Divizionit Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, palë në procedurë ankimore duhet gjithnjë të jetë administrata kompetente fiskale, doganore ose administrata komunale, e cila e ka lëshuar vendimin e ankimuar;

1.2. para Gjykatës së Apelit si gjykatës i shkallës së dytë dhe Gjykatës Supreme si gjykatës i shkallës përfundimtare, ankues apo paditës, mundet, po ashtu të jetë administrata fiskale, doganore ose administrata komunale, e cila ka vepruar si e pandehur në shkallën e parë;

1.3. tatimpaguesi mund të marrë pjesë në gjykatën kompetente pa qenë i/e përfaqësuar ose ndihmuar nga një avokat ose këshilltar profesional tatimor, kur vlera e kundërshtimit është më e vogël se pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro;

1.4. administrata tatimore dhe doganore dhe çdo autoritet kompetent duhet të përfaqësohet dhe mbrohet para gjykatave nga shërbyesit zyrtar ligjor, përveç nëse duan të ndihmohen nga avokat profesional.

2. Njësia e Hetimeve Tatimore do të mbështetet nga një ekip i inteligjencës për qëllim të zbulimit të rasteve potenciale tatimore kriminale. Drejtori i Përgjithshëm mund të përshkruaj sipas nevojës më shumë detyra përkatëse ekipit të inteligjencës dhe njësisë së hetimit për zbulimin efektiv dhe hetimin e krimit tatimor.

Neni 81.E Përmbajtja e ankesës

1. Një tatimpagues i cili ka marrë një vendim nga Sektori i Ankesave ose nuk ka pranuar ndonjë vendim brenda kohës së paraparë sipas paragrafit 2. të nenit 3 të këtij ligji, ose nuk ka pranuar vendimin e kërkuar nga administrata kompetente tatimore ose doganore brenda kohës së paraparë me ligj, mund të ushtroj ankesë në Divizionin Fiskal të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

2. Kërkesa nga pala e interesuar për të iniciuar masa ligjore tek gjykata kompetente duhet të bëhet me shkrim dhe dorëzohet në të njëjtën kohë tek gjykata dhe pala kundërshtare.

3. Një ankesë e adresuar tek Gjykata Themelore duhet të përmbajë njërën nga kërkesat në vijim:

3.1. anulimin, e plotë ose të pjesshëm, të vendimit të kundërshtuar; ose

3.2. kthimin e tatimit të paguar padrejtësisht, i cili nuk është nxjerrë sipas kushteve të parapara; ose

3.3. merr vendim i cili nuk është sjellë nga administrata kompetente fiskale dhe doganore;

3.4. merr vendim për të zvogëluar borxhin doganor, i cili nuk është marrë sipas kushteve të parapara; ose

3.5. kthimin e gjërave të konfiskuara dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar për shkak të ekzekutimit të vendimit kontestues.

4. Ankesa duhet të përmbajë:

4.1. emrin e administratës kompetente tatimore ose doganore e cila ka marrë vendimin e kundërshtuar ose që nuk ka marrë vendimin e kërkuar brenda kohës së paraparë sipas nenit 77 të ligjit bazik;

4.2. numrin e referencës dhe datën e vendimit të kundërshtuar;

4.3. detajet personale të paditësit;

4.4. arsyetimin ligjor dhe faktik, përveç atyre të shfaqura në nenin 16 të Ligjit mbi konfliktet administrative, për ankesa;

4.5. faktet në mbështetje të kërkesës;

4.6. çdo dokument tjetër që mendohet të jetë relevant në masa;

4.7. nënshkrimi i apeluesit apo të përfaqësuesit të autorizuarit të apeluesit;

5. Nëse personi që ankohet në gjykatë dëshmon që koha e shfaqur në paragrafin 7. të nenit 14 të ligjit bazik ose gjatë procedurës ankimore para Departamentit të Ankesave, ai/ajo nuk ka mundur të dorëzoj dokumentacionin ose provat tjera për shkak të arsyeve që ishin jashtë kontrollit të tij/saj, ai/ajo do të lejohet të dorëzoj ato për herë të parë në gjykatë.

6. Gjykata do të vendos mbi arsyeshmërinë e pengesave të pretenduara nga paditësi.

7. Në rast se ankesa nuk është e plotë, neni 33 i Ligjit mbi konfliktet administrative do të gjej zbatim.

Neni 81.F Detyrimi i vërtetimit

1. Tatimpaguesi do të bartë detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj.

2. Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bartë detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit.

3. Provat e mbledhura nga procedurat penale tatimore dhe doganore dhe vendimi i gjykatësit penal, mund të përdoret në procesin gjyqësor para Divizionit Fiskal, mbi bazën e identifikimit të fakteve dhe personave.

Neni 81.G Seanca e shqyrtimit

1. Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykata e Apelit duhet të mbajnë seanca publike ku palët dëgjoen dhe provat shqyrtohen.

2. Gjykata mund të mbaj seanca të mbyllura, kur ekzistojnë arsye të duhura në lidhje me sigurinë dhe çështjet konfidenciale të përfshira.

Neni 81.H Procedura para Gjykatës së Apelit

1. Kërkesa për ankesë kundër Divizionit Fiskal të Gjykatës themelore duhet të adresohet dhe dorëzohet tek Gjykata e Apelit dhe palët kundërshtarë.

2. Ankesa e adresuar tek Gjykata e Apelit duhet të përmbajë kërkesën për anulimin, e plotë ose të pjesshëm të vendimit të kundërshtuar nga Gjykata Themelore.

3. Ankesa e ushtruar kundër vendimit të Divizionit Fiskal të Gjykatës Themelore duhet të përmbajë:

3.1. numrin e referencës dhe datën e vendimit të lëshuar nga Gjykata Themelore;

3.2. detajet personale të paditësit;

3.3. detajet personale të të paditurit;

3.4. arsyet, ligjore dhe faktike për ankesë;

3.5. provat që mbështesin kërkesën;

3.6. çdo dokument tjetër që konsiderohet relevant në seancë;

3.7. nënshkrimin e ankuesit apo të autorizuarit të tij/saj.

4. Asnjë provë, përveç atyre tashmë të dorëzuara gjatë fazës së instancës së parë, nuk mund të paraqiten. Gjykata mund të lejoj prova të reja kur:

4.1. provat nuk kanë qenë në dispozicion gjatë kohës së kundërshtimit të vendimit;

4.2. provat janë të nevojshme për të evituar shfaqjen e padrejtësive për palën e cila e kërkon shqyrtimin e tyre.

5. Vendimi i Gjykatës Themelore mund të kundërshtohet përmes gjykatës kompetente brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të komunikimit të tij zyrtar tek palët.

6. Nëse nuk dorëzohet ndonjë ankesë brenda afatit të lartë shënuar, vendimi i Gjykatës Themelore konsiderohet të jetë definitiv.

Neni 81.I Vendimet gjyqësore

1. Në pajtim me nenin 9 dhe nenin 34 të Ligjit mbi konfliktet administrative, padia mund të miratohet, plotësisht ose pjesërisht ose të refuzohet.

2. Gjykata që merr vendimin mbi padinë duhet të:

2.1. konfirmoj vlefshmërinë e vendimit të kundërshtuar dhe të refuzoj ankesën; ose

2.2. shfuqizoj ose anuloj tërësisht vendimin dhe të vërtetoj ankesën; ose

2.3. shfuqizoj ose anuloj pjesërisht vendimin dhe sipas rrethanave të vërtetoj ankesën; ose

2.4. udhëzoj organin kompetent për të lëshuar vendimin kur nxjerrja e tij është refuzuar ose vonuar në mënyrë të paligjshme.

3. Vendimi i Gjykatës do të jetë detyrues për të dy personat që ankohen dhe administratën tatimore ose doganore ose ndonjë autoritet tjetër të përfshirë, nga momenti i komunikimit zyrtar të tij tek palët.

4. Për zbatimin e vendimit të Gjykatës (paragrafit 3. i këtij neni) zbatohet neni 46, paragrafët 4. dhe 5. dhe neni 65 i Ligjit mbi konfliktet administrative.

5. Nëse vendimet e Gjykatës Themelore ose të Gjykatës së Apelit kundërshtohen nga gjykata kompetente, pala e interesuar mund të kërkojë suspendim të ndikimit të tyre për kohën që nevojitet për të vazhduar kundërshtimin duke siguruar një garancion të duhur bankar për tatimin dhe doganën e papaguar.

Neni 81.J Marrëveshja tatimore

1. Para seancës, palët mund të rregullojnë konfliktin, tërësisht ose pjesërisht, përmes një marrëveshjeje mbi çështjet dhe shumën e tatimeve, detyrimeve, gjobave ose interesit përkatës.

2. Marrëveshja duhet të jetë me shkrim dhe bëhet definitive sapo të ratifikohet nga gjykata në bazë të përmbushjes së saj me parimet e drejtësisë dhe transparencës.

3. Sapo të bëhet definitive marrëveshja, seanca gjyqësore para gjykatës përfundon dhe nuk lejohen kërkesa tjera mbi faktet e njëjta nga administrata fiskale ose doganore.

4. Nëse marrëveshja është e pjesërishme, gjykimi do të vazhdojë për të shqyrtuar pjesën e mbetur.

Neni 9 Obligimi për pagesë gjatë seancave ankimore

1. Neni 82 i ligjit bazik paragrafi 1. riformulohet si në vijim:

1. Nëse një person ka dorëzuar ose nuk ka dorëzuar një ankesë te Sektori i Ankesave, Bordi i Pavarur për Rishqyrtime ose gjykata kompetente, nuk pezullon obligimin për pagesë të detyrimeve tatimore.

2. Neni 82 i ligjit bazik paragrafi 2. riformulohet si në vijim:

2. Duke mos rënë në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni, mbledhja e tatimit përmes masës për marrjen e pasurisë është e ndaluar në pasurinë e paluajtshme, për deri sa tatimpaguesi ka të drejtë të ankohet në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime ose në gjykatën kompetente. Çdo tatimpagues që dëshiron të shtyjë veprimin e mbledhjes së tatimit para se të bëjë një ankesë te Bordi i Pavarur për Rishqyrtime ose gjykatë kompetente, mund të dorëzojë një garancion bankar ose formë tjetër të sigurisë të pranueshme nga Administrata Tatimore, për një shumë të mjaftueshme për të mbuluar tatimin, gjobën, plus interesin e tillë që mund të rritet gjatë çdo veprimi pasues.

Neni 10 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-102
19 prill 2012**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-018-2012, datë 17.05.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**